



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236233

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06553223

AC-I-23-0393

Në ankesën e

Paditësi

R B nga fshati Sh, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH NewCo "Grand Hotel SH.P.K", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1231 të datës 02 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-15-1231 i datës 02 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 16 korrik 2015, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë/kërkesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN173-0376, të datës 27 maj 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për pagesën e pagave të pa paguara në shumë prej 2,208.03 € nga N.SH "NewCo Grand Hotel", Prishtinë për periudhën dhjetor 2011 deri më 06 gusht 2012, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi në ankesë është deklaruar se ankesën e ushtron për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Paditësi ka theksuar se ka qenë i punësuar te NSH deri në momentin e fillimit të procedurës së likuidimit, unë kam punuar në Grand Hotel Prishtina pavarësisht se si është privatizuar e si është transferuar e drejta e pronësisë. Tutje ka shtuar se në momentin kur ka filluar likuidimi më dt. 02.02.2015, për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri më 06 gusht të vitit 2012, mua nuk më janë paguar pagat dhe shuma e pagave të pa paguara është 2,208.03 €. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit kërkesën time e ka refuzuar për shkak se është thirr në parashkrim sipas nenit 608, të Ligjit mbi punën e bashkuar. Në vazhdimësi i kemi kërkuar pagimin e pagave, me punëtorët tjerë dhe më dt. 07.08.2012, ne kemi pranuar një përgjigje nga Zëvendësdrejtori se pagat e pa paguara do të realizon në procedurën e likuidimit të ndërmarrjes.

Ka kërkuar që të anulohet Vendimi i AL dhe të aprovohet kërkesa për pagat e pa paguara në shumën 2,208.03 €. Kësaj parashtrese, nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë.

Më 13 dhjetor 2022, Gjyqtari i Shkallës së parë i DHPGJS, me urdhër ka kërkuar nga paditësi që të plotëson ankesën e ushtruar kundër Vendimit të AL PRN173-0376, duke dorëzuar kopjen e Vendimit të AL, dhe të gjitha provat mbi bazën e të cilave i mbështesni pretendimet e tij.

Më 29 dhjetor 2022, dhe me parashtresën e dt. 02 shkurt 2023, paditësi ka dorëzuar: Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN173-0376, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e dt. 02 shkurt 2015, e lëshuar nga AKP –ja, Shkresën e dt. 20 tetor 2014, nga mbledhja e punëtorëve për formimin e komisionit profesional, Regjistrin e pagave të pa paguara, për periudhën kontestuese ku

paditësi gjendet me nr.27, Librezën e punës, Llogarinë bankare , kontratën e punës 01 janar 2015.

Më 04 janar 2023, AKP- ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. AKP-ja në parashtresë të mbrojtjes ka pohuar faktin se NSH,, New co Grand Hotel sh.p.k” ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 02 shkurt 2015, ndërsa paditësi më datë 18 mars 2015 ka ushtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën 2,208.03 euro për periudhën dhjetor 2011 deri më 06 gusht 2012. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa është parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë ndonjë dëshmi që i ka kërkuar këto paga më parë në ndonjë gjykatë kompetente. Pasi që kërkesa është parashkruar, AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk ka pasur mundësi t’i shqyrtojë meritat e rastit. Nga këto arsye, AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me 02 qershor 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1231, ankesën e paditësit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si dhe ka obliguar AKP-në ti paguaj paditësit pagat e papaguara në shumën prej 2,007.00 euro për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri në gusht 2012, sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës përtej kësaj shume e ka refuzuara si të pabazuar. Shkalla e parë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa për pagat e papaguara për periudhën e lart cekur nuk është parashkruar siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, pasi që nga regjistri i pagave i cili është nënshkruar nga organet e NSH-së është pohim i borgjit dhe se ky pohim i borgjit e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës dhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar. Tutje shkalla e parë konstaton se me përgjigjen e AKP-së të datës 07.08.2012, vërtetohet fakti se AKP-ja ka qenë e njoftuar me situatën e mos pagesës së pagave të punëtorëve të NSH-së, si kundër që me këtë përgjigje punëtorët janë njoftuar se kërkesat e tyre për paga do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. Shkalla e parë ka vlerësuar se kërkesa e paditësit nuk është kundërshtuar nga e paditura për periudhën dhjetor 2011 deri në gusht të vitit 2012,

ndërsa shuma përtej shumës së aprovuar nuk është e bazuar pasi ajo nuk është provuar me asnjë provë nga paditësi, sipas barrës së provës. Tutje shkalla e parë konstaton se nuk është lëshuar në aspektin e vlerësimit të lartësisë së kërkuar, meqë e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumes se kërkuar sikurse edhe mos pagesën e pagave. Shkalla e parë ka konstatuar me provat të cilat i ka paraqitur paditësi vërtetohet se ai ka qen kryer shërbime pune për NSH-në në periudhën e cekur, se ka qen punëtor i NSH-se dhe se me njoftimit e te paditurës, paditësit i ishte ndërprerë e marrëdhënia e punës ne NSH. Andaj është aprovuar shuma në emër të pagave të papaguara 2,007.00 €, që do të paguhet në bazë të nenit 40.1.1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Me 21 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS C-IV-15-1231 të datës 02 qershor 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se Aktgjykimi i ankimuar nuk i plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 54 i LDHP-së, pasi që nuk pasqyron drejtë gjendjen faktike e cila ka rëndësi materiale lidhur me kërkesën. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa është parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë ndonjë dëshmi që i ka kërkuar këto paga më parë në ndonjë gjykatë kompetente. Andaj paditësi nuk ka të drejtë në pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me 18 tetor 2024, Shkalla e dytë lëshoj urdhër për dërgimin e ankesës tek paditësi per përgjigje, mirëpo ankesa nuk kishte mundur ti dërgohet paditësit.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së C-IV-15-1231 i datës 02 qershor 2023, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 18 mars 2015 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara për periudhën dhjetor 2011 deri më 06 gusht 2012 nga NSH New Co "Grand Hotel Sh.p.k", në shumë prej 2,208.03 €. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e AL PRN173-0376 dhe e ka obliguar AKP-në të i'a paguaj paditësit pagat e pa paguara në shumën prej 2,007.00€, për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri në gusht të vitit 2012 duke konstatuar se kërkesa për paga nuk është parashkruar. Pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar e ka refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e parë ka bashkangjitur: Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN173-0376, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e dt. 02 shkurt 2015, e lëshuar nga AKP -ja, Shkresën e dt. 20 tetor 2014, nga mbledhja e punëtorëve për formimin e komisionit profesional, Regjistrin e pagave të pa paguara, për periudhën kontestuese ku paditësi gjendet me nr.27, Librezën e punës, Llogarinë bankare, kontratën e punës 01 janar 2015.

Në bazë të këtyre provave të bashkangjitura dhe siç ka konstatuar edhe shkalla e parë, nga regjistri i pagave të punëtorëve për periudhën e vitit 2011 deri në gusht të vitit 2012, i nënshkruar nga organet e NSh-së, vërehet se NSH e ka pohuar borgjin, andaj ky pohim i borgjit e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës dhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar siç pretendon e paditura.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt dhe në listën e pagave të cilën paditësi e ka sjellë si provë, Shkalla e parë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht shumën prej 2,007.00€, në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 05 dhjetor 2024

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

Ramë Bytyqi,